



RAPORT VJETOR 2024-2025

A. PËRSHKRIM I VEPRIMTARISË SË NJSBCZHK.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) është njësi e ngritur në nivel universiteti. Përbërja dhe funksionimi i kësaj njësie është miratuar nga Rektori. Mënyra e funksionimit të NJSBCZHK rregullohet me rregullore të veçantë.

Kjo njësi përbëhet nga 9 anëtarë: drejtuesja e zyrës, anëtarë të tjerë të kësaj zyre që janë përzgjedhur nga pedagogët e çdo departamenti, përfaqësues nga administrata. Kësaj njësie i është bashkuar edhe një student si përfaqësues nga Këshilli i Studentor.

Kjo njësi është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe ruajtjen e standarteve në UMSH, bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë në Shqipëri, strategjisë për zhvillim, politikave dhe akteve rregullatore të institucionit. NJSBCZHK përmes mekanizmave të sigurimit të cilësisë, dhe shumë proceseve të tjera të vazhdueshëm monitoron, vlerëson, ruan dhe përmirëson cilësinë e institucionit dhe të programeve të ofruara.

NJSBCZHK vlerëson në mënyrë periodike efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore ose artistike, si dhe efikasitetin e veprimtarive administrative të institucionit.

Secili anëtar i NJSBCZHK përgatit raportin e vlerësimit për veprimtarinë e monitoruar dhe mban përgjegjësi të plotë deri në dorëzim të raportit me shkrim dhe të firmosur në dosjen e njësisë.

NJSBCZHK-ja ka autonomi operative dhe akses në të dhënat e institucionit.

Të gjitha rezultatet e planveprimit të NJSBCZHK publikohen përmes një raporti të brendshëm që i dërgohet Rektorit të UMSH.

Në varësi të vlerësimit dhe monitorimit, çdo raportim që lidhet me Fakultetet përkatëse i vihen në dispozicion edhe Dekanëve të Fakulteteve dhe Drejtuesëve të Njësisë Bazë.

Raporti vjetor i njësisë dhe tërësia e veprimtarisë (dokumenta, raporte, etj) dorëzohet tek Rektori në fund të vitit akademik.

Nr	Anëtarët /Punonjës të NJSBC	Detyra që ka në NJSBC
1	Holta Heba	Kryetare
2	Emilio Çika	anëtar
3	Fiona Tako	anëtar
4	Sonila Nikolla	anëtar
5	Armelina Lila	anëtar
6	Ina Shehu	anëtar
7	Besiana Mema	anëtar
8	Gazmir Gjoni	Anëtar
9	Anisa Bika	Asistent administrativ
	Emër Mbiemër	Detyra që ka në NJSBC
	Leonida Lleshaj	student

B. Planveprimi për vitin akademik 2024-2025

Metodologjia e punës së kësaj njësie është e bazuar në: Rregulloren e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, manualin e saj, Ligjin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Nr.80/2015; Date 22.07.2015; Neni 103 dhe 104, Statutin e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë; Nenin 53 dhe 84 dhe në rregulloren e UMSH neni 28, si dhe të gjitha dokumentet e ASCAL-it.

Planveprimi i NJSBCZHK për 2024-2025

Në fillim të vitit akademik, NJSBCZHK ka paraqitur në Rektorat planveprimin e saj. Ky planveprim është hartuar në bazë të politikave dhe strategjive institucionale për zhvillimin, përmirësimin dhe ruajtjen e standarteve si dhe në bazë të nevojave të institucionit për sigurimin e standarteve dhe cilësisë.

Planveprimi i NJSBCZHK është hartuar sipas kalendarit akademik 2024-2025.

Bazuar në kalendarin akademik 2024-2025 të miratuar nga Rektorati, në periudha të ndryshme të vitit akademik, njësia ka zhvilluar aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me njësitë bazë të UMSH. NJSBCZHK ka bashkëpunuar me njësitë bazë të UMSH, duke pasur si qëllim parësor sigurimin e cilësisë dhe ruajtjen e standarteve sipas udhëzimeve të ASCAL dhe sipas strategjisë së Institucionit. Për sa i përket planveprimit të NJSBCZHK, ai është hartuar në drejtim të: mësimdhënies, mësimnxënies, ecurisë së procesit mësimor, marrëdhënies pedagog-student, si dhe marrëdhënies departament-student.

Planveprimi është bërë i njohur për njësitë bazë dhe kryesore që në fillim të vitit akademik. NJSBCZHK ka vënë në dijeni këto njësi para dhe pas cdo procesi monitorimi. Në fund të vitit akademik ka dorëzuar në Rektorat dosjen e plotë me raportet e nxjerra nga monitorimet. Kësaj dosjeje i është bashkangjitur dhe raporti vjetor i kësaj njësie.

C. AKTIVITETET E VLERËSUARA

NGA NJSBCZHK PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025 NË UMSH

1. **Takimet e paraprake të NJSBCZHK para cdo monitorimi.** Si cdo fillim viti, NJSBCZHK është mbledhur për të diskutuar rreth planveprimit të këtij viti akademik, si dhe mënyrat se si do të zhvillohen monitorimet sipas rubrikave përkatëse. Gjatë ndarjeve të monitorimeve, është përcaktuar që monitoruesit të mos jenë pjesë e njësisë bazë, apo njësisë që monitorohet.
2. **Ndarja e detyrave për cdo anëtar, në takim dhe me email.** Anëtarët e njësisë kanë marrë në mënyrë propocionale dhe transparente, në mënyrë që ngarkesa të jetë e njëjtë për të gjithëku të pranishëm në të gjitha proceset kanë qenë të gjithë anëtarët e NJSBCZHK. duke vënë në dijeni edhe drejtuesit e njësive bazë, kryesore dhe Rektoratin.
3. **Zhvillimi i monitorimeve.** Nën drejtimin e drejtueses së zyrës, anëtarët e NJSBCZHK kanë realizuar monitorimet apo vlerësimet për cdo aktivitet sipas rubrikave të planveprimit dhe në fund kanë patur detyrimin që të bëjnë raport me shkrim.
4. **Shpërndarja dhe përdorimi i një model raporti për cdo proces.** Para fillimit të cdo aktiviteti, NJSBCZHK ka zhvilluar takime konsultuese për mënyrën e vlerësimit si dhe për përdorimin e modelraporteve të përbashkët për të gjithë anëtarët.
5. **Kontrolli i dosjeve të doktorantëve:** Në zbatim të kërkesave akademike dhe administrative të programit të doktoratës, u zhvillua një kontroll i përgjithshëm i dosjeve të doktorantëve të regjistruar në vitin e parë dhe të dytë të studimeve për vitin akademik 2024–2025. Kontrolli kishte për qëllim verifikimin e përmbushjes së detyrimeve dokumentare të secilit doktorant sipas fazës përkatëse të studimeve.
6. **Detyra të tjera jashtë planveprimit.** Me kërkesë të Rektoratit dhe Komisionit të përhershëm për Sigurimin e Cilësisë ka kryer edhe veprime të tjera administrative sipas

rastit dhe nevojave që ka patur Rektorati përgjatë zhvillimit të procesit mësimor të vitit akademik 2024-2025.

7. **Mirëmbajtja e Share folder.** NJSBCZHK është kujdesur përgjatë gjithë vitit akademik 2024-2025 që në SHARE FOLDER, UMSH Dokumentacione të hidhen të gjitha materialet e nevojshme për stafin akademik dhe administrativ, ku sipas nevojave apo proceseve të ndryshëm, individidët e lejuar aksesojnë materialet përkatëse.
8. **Monitorimi semestral i pedagogëve dhe lendeve.** NJSBCZHK në bashkëpunim me drejtuesit e njësisë bazë ka ndërtuar dhe zhvilluar programin SEMESTRAL për monitorimin e zhvillimit të mesimit. Programi është hartuar duke pasur parasysh objektivat e departamenteve dhe të vetë njësisë.
9. **Kontaktet/Takimet me koordinatorët dhe sekretarinë.** NJSBCZHK ka mbajtur kontakte të rregullta me koordinatorët e fakulteteve dhe sekretarinë në lidhje me njoftimet e studentëve për secilin proces akademik.
10. **Monitorimi i dokumentacionit në njësinë bazë.** Në kuadër të ruajtjes së dokumentacionit në njësinë bazë, këtë vit akademik NJSBCZHK ka zhvilluar monitorime në të gjitha njësitë bazë. Fillimisht është proceduar me njoftim të drejtuesëve të njësisë bazë për monitorimin e dokumentacionit dhe më pas është vijuar me dërgimin me email (për kujtesë) e një liste dokumentacionesh që cdo drejtues njësie bazë duhet të vendoste në dispozicion të NJSBCZHK.
11. **Vlerësimi i pedagogut dhe lëndës nga studenti, në fund të semestrave.** Sipas planit të punës të kësaj njësie, këtë vit akademik janë zhvilluar dhe vlerësimet për lëndën dhe pedagogun në fund të dy semestrave. Këtë vit akademik, vlerësimi është kryer online dhe në auditor ku NJSBCZHK ka marrë masa që të njoftojë studentët për rëndësinë e këtij procesi. Njoftimi është bërë nëpërmjet classroomeve të tutorëve akademik, por edhe nga anëtarët e njësisë të cilët kanë hyrë në cdo sallë për t'u ardhur në ndihmë studentëve në plotësimin e linkut.
12. **Focus Grupet në dy semestra për BSC dhe MSC dhe Doktorature.** Krahas vlerësimit për pedagogun dhe lëndën janë realizuar edhe Focus Grupet me studentët duke njoftuar drejtuesit si fillim për lejen e tërheqjes së studentëve të cdo program studimi si dhe duke njoftuar pedagogët që të jenë bashkëpunues për këtë proces. Focus groupi është zhvilluar në një sallë të caktuar dhe në orare të ndryshme. Sipas metodologjisë së miratuar nga

Rektorati për zhvillimin e këtij procesi, drejtuesja e NJSBCZHK ka marrë të gjitha masat për realizimin me sukses të tij, duke nisur që nga prania e studentëve, respektimi i pyetësorit, respektimi i të drejtave të studentit si dhe mbajtja e procesverbalit nga një anëtar i administratës.

13. Monitorimi i punimeve të diplomave dhe procesverbalit të mbrotjes së diplomave.

NJSBCZHK ka monitoruar në njësitë bazë procesverbalet e punimit të diplomave dhe diplomat e dorëzuara që kanë kaluar në komision mbrotjeje sipas udhëzimit të rektoratit, duke pasur si fletë shoqëruese: vlerësimin e udhëheqësit, oponentit dhe vlerësimin për antiplagjiaturë.

14. Takimet e përmuajshme të NJSBCZHK me këshillin studentor.

Të gjitha takimet me përfaqësuesit e studentëve kanë procesverbal takimi të veçantë. Këto takime kanë bërë të mundur krijimin e një elementi thelbësor për marrjen e reagimeve të drejtpërdrejta, pikëpamjeve dhe opinioneve nga studentët e UMSH si dhe përcjelljen e mendimeve, ideve apo vendimeve të institucionit tek studentët.

15. Monitorimi i syllabuseve të dorëzuara në njësinë bazë.

Si çdo vit, në kuadër të planveprimit të NJSBCZHK, janë realizuar edhe monitorimet e syllabuseve në UMSH Dokumentacione sipas folderave të departamenteve përkatës. Monitorimet e syllabuseve të miratuar janë kryer në fillim të çdo semestri. Grupet e punës janë ndarë në dy persona për secilin grup dhe kështu raporti i monitorimit mban firmën e dy anëtarëve të NJSBCZHK.

16. Monitorimi i provimeve përfundimtare.

NJSBCZHK ka zhvilluar monitorimin e provimeve përfundimtare, të dorëzuara në njësinë bazë. Është monitoruar mënyra e korrigjimit, numri i tezave që përkon me listprezencën si dhe respektimi i formatit të tezës së provimit, sipas udhëzimit nga Rektorati.

Për vëmendje:

Të gjitha proceset e mësipërme janë të dokumentuara me datat dhe analizat përkatëse në dosjen e NJSBCZHK, të dorëzuar në Rektorat.

D. ANALIZË E VEPRIMTARIVE TË KRYERA PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025.

- SHARE FOLDER me UMSH është ristrukturuar në foldera të vecantë dhe përmbajtja që ka qenë deri në ristrukturim ka kaluar në folderin Arkivë, ku në çdo moment pedagogët, përgjegjësit e departamenteve dhe grupet e punës për RVB kanë aksesuar për nxjerrjen e rregulloreve, formateve, udhëzimeve etj; sigurisht sipas nevojave.
- Gjatë monitorimit të syllabuseve në të dy semestrat është vërejtur se një përqindje shumë e lartë e ka respektuar formatin me rigorozitet.
- NJSBCZHK ka monitoruar takimet e studentëve me tutorët akademik, ku në të gjitha rastet ka qenë pjesë e njoftimeve për zhvillimin e tyre si dhe e pranishme.
- Një herë në muaj, NJSBCZHK ka qenë prezente edhe në takimet me Këshillin studentor, nga i cili ka marrë shumë të dhëna mbi mbarëvajtjen e procesit mësimor, të cilat më pas i ka përcjell në Rektorat, sipas rastit dhe nevojës.
- Kalendari monitorues ka qenë semestral. Për çdo monitorim është realizuar raport vlerësimi dhe nga anëtari i NJSBCZHK si dhe dhe përgjegjësi i departamentit. Njësia ka shprehur mendimin e saj në raportin individual. Gjatë këtij viti akademik vlerësimet kanë rezultuar tepër të mira, përveç rastit të një pedagogu, të cilit i është tërhequr vëmendja për ta zhvilluar mësimin në formë më interaktive.
- Në javën e 13-të të çdo semestri është zhvilluar edhe vlerësimi i studentit për PEDAGOGUN dhe LËNDËN për BSC dhe MSC. Studentëve i është dërguar linku online. Vlerësimi i tyre ka mbetur anonim. Në fund të procesit në të dy semestrat, vlerësimet janë përpunuar dhe janë dorëzuar në Rektorat. Ky i fundit në të gjitha rastet, ia ka bërë me dije pedagogut vlerësimin që kanë studentët e këtij viti për të dhe për lëndën përkatëse.
- Focus grupet për doktoraturën janë zhvilluar në janar dhe në qershor të këtij viti akademik, ku gjatë takimit, pjesëmarrësit ndanë mendimet e tyre mbi përvojat në programin doktoral, veçanërisht në lidhje me fazën e ndërtimit të kornizës teorike dhe metodologjike të punimit të tyre. U theksua cilësia e mentorimit dhe mbështetja nga udhëheqësit shkencor që rezultojnë të jetë përjetuar pozitivisht, në përputhje me nevojat e secilit doktorant në fazën aktuale të studimit.
-

- Realizimi i focus grupeve për BSC dhe MSC në fund të dy semestrave, si dhe në janar dhe qershor për Doktoraturën, ka rezultuar efektiv për ruajtjen e standarteve dhe cilësisë në UMSH.
- Njësia ka kërkuar bashkëpunimin e përfaqësuesëve të studentëve (në të tri ciklet e studimit, BSC, MSC dhe DOKTORATURË) për pjesmarrje të lartë në takimet e tutoriatit si dhe sensibilizim të studentëve për të qenë sa më aktiv në jetën studentore.

E. SUGJERIME TË PËRGJITHSHME (të vlefshme për të gjitha programet)

Bazuar në raport, rekomandohet:

- rritja e ndërveprimit pedagog–student, veçanërisht përmes metodave aktive të mësimdhënies;
- standardizimi dhe kontrolli rigoroz i syllabuseve, duke siguruar përputhje të plotë me formatet institucionale;
- forcimi i praktikave profesionale dhe laboratorike, si një nga gjetjet kryesore për përmirësim;
- përdorimi më sistematik i feedback-ut të studentëve dhe rezultateve të focus grupeve në rishikimin e kurrikulave;
- rritja e komponentit të vlerësimit të vazhdueshëm dhe transparent.

F. SUGJERIME SIPAS PROGRAMEVE TË STUDIMIT

1. Diploma Profesionale në Teknologji Informacioni & Aplikime Informatike

Bazuar në monitorimet e zhvillimit të mësimin dhe dokumentacionit, është konstatuar nevoja për rritjen e komponentit praktik dhe ndërveprimit aktiv pedagog–student. Sugjerohet rritja e orëve laboratorike dhe përdorimi i metodave praktike të demonstrimit, veçanërisht në profilet e rrjeteve, pajisjeve elektronike dhe software-it. Gjithashtu, rekomandohet përditësimi periodik i syllabuseve për të reflektuar zhvillimet e shpejta në teknologjitë e informacionit dhe digjitalizim.

2. Diplomë Profesionale Menaxhim dhe Marketing i Turizmit

Nga vlerësimet e studentëve dhe focus grupet, evidentohet nevoja për më shumë raste studimore reale dhe aplikim praktik të njohurive teorike. Sugjerohet forcimi i bashkëpunimit me operatorë turistikë dhe struktura hoteliere për praktika profesionale të strukturuar. Po ashtu, rekomandohet integrimi i marketingut digjital dhe turizmit të qëndrueshëm në përmbajtjen kurrikulare.

3. Bachelor Shkenca Ekonomike

Monitorimi i syllabuseve dhe provimeve ka treguar përputhje të mirë me formatin institucional, por studentët kanë kërkuar më shumë aplikime praktike. Sugjerohet rritja e përdorimit të analizave financiare reale, rasteve bankare dhe simulimeve ekonomike. Gjithashtu, rekomandohet integrimi i mjeteve digjitale në lëndët e kontabilitetit dhe financës.

4. Bachelor në Informatikë

Nga monitorimet semestrale është evidentuar rëndësia e mësimdhënies interaktive dhe punës në grup. Sugjerohet rritja e projekteve praktike, veçanërisht në profilet e Inxhinierisë Informatike dhe Informatikës së Biznesit. Përditësimi i syllabuseve me elemente të AI, cloud dhe sistemeve moderne të informacionit do të përmirësonte ndjeshëm cilësinë.

5. Drejtësi (Program i Integruar 3+2)

Monitorimi i diplomave dhe procesverbaleve të mbrojtjes ka treguar respektim të standardeve, por sugjerohet rritja e analizës së rasteve gjyqësore konkrete gjatë procesit mësimor. Studentët përfitojnë më shumë nga lidhja e teorisë me praktikën juridike. Rekomandohet gjithashtu standardizim i mëtejshëm i metodave të vlerësimit.

6. Bachelor Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare

Bazuar në vlerësimet e studentëve, sugjerohet rritja e diskutimeve analitike dhe debateve të strukturuar në auditor. Përfshirja e dokumenteve dhe politikave reale ndërkombëtare do të forconte kompetencat analitike. Gjithashtu, rekomandohet nxitja e mobilitetit akademik dhe praktikave institucionale.

7. Bachelor Shkenca Politike dhe Administrative

Monitorimet kanë evidentuar nevojën për më shumë metoda aktive mësimdhënieje. Sugjerohet përdorimi i simulimeve administrative dhe analizës së politikave publike shqiptare dhe europiane. Kjo qasje rrit përfshirjen e studentëve dhe lidhjen me realitetin institucional.

8. Bachelor Studime Psikosociale

Nga focus grupet rezulton nevoja për më shumë praktikë në terren. Sugjerohet zgjerimi i bashkëpunimit me institucione sociale dhe shëndetësore. Gjithashtu, rekomandohet reflektimi sistematik i feedback-ut të studentëve në përditësimin e syllabuseve.

9. Bachelor Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun

Monitorimet tregojnë se studentët përfitojnë më shumë nga projekte praktike dhe studime rasti. Sugjerohet rritja e komponentit të komunikimit digjital dhe menaxhimit të krizave. Përmirësimi i ndërveprimit pedagog–student do të ndikonte pozitivisht në cilësinë e mësimin.

10. Bachelor Mësuesi për Arsimin Parashkollor

Raporti evidenton rëndësinë e praktikave mësimore. Sugjerohet rritja e orëve praktike dhe përdorimi i metodologjive bashkëkohore të edukimit të hershëm. Gjithashtu, rekomandohet integrimi i teknologjisë edukative.

11. Bachelor Mësuesi për Arsimin Fillor

Bazuar në monitorime, sugjerohet forcimi i metodave interaktive dhe përdorimi i mjeteve digjitale në mësimdhënie. Rritja e praktikave të mbikëqyrura do të përmirësonte përgatitjen profesionale të studentëve.

12. Bachelor Infermieri e Përgjithshme

Monitorimi i praktikave klinike tregon rëndësinë e strukturimit të tyre. Sugjerohet zgjerimi dhe dokumentimi më i detajuar i praktikës profesionale. Përditësimi i syllabuseve sipas protokolleve bashkëkohore shëndetësore është i domosdoshëm.

13. Bachelor Fizioterapi

Sugjerohet rritja e praktikës së drejtpërdrejtë dhe përdorimi i pajisjeve moderne rehabilituese. Monitorimet tregojnë nevojën për standardizim të vlerësimit të praktikës.

14. Bachelor Teknik Laboratori

Bazuar në monitorimin e dokumentacionit, rekomandohet përmirësimi i protokolleve laboratorike dhe rritja e orëve praktike. Respektimi rigoroz i standardeve të sigurisë është thelbësor.

15. Master Profesional Menaxhim Biznesi

Nga focus grupet rezulton nevoja për më shumë raste reale biznesi. Sugjerohet përdorimi i projekteve aplikative dhe analizave strategjike sipas profileve përkatëse.

16. Master Profesional Auditim i Brendshëm dhe Kontrolli Financiar

Sugjerohet integrimi i standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe përdorimi i softuerëve profesionalë. Monitorimet tregojnë rëndësinë e unifikimit të metodave të vlerësimit.

17. Master Profesional Sistemet e Informacionit në Biznes

Raporti evidenton nevojën për projekte praktike. Sugjerohet fokus në ERP, BI dhe sigurinë e informacionit, duke reflektuar transformimin digjital.

18. Master Profesional Marrëdhënie Ndërkombëtare

Sugjerohet thellimi i analizës së politikave europiane dhe mesdhetare. Përdorimi i dokumenteve reale rrit cilësinë akademike.

19. Master Profesional Shkenca Politike dhe Administrative

Bazuar në monitorime, rekomandohet analiza e rasteve konkrete nga administrata publike dhe qeverisja vendore.

20. Master Profesional Hartim dhe Menaxhim Projektsh

Raporti sugjeron nevojën për aplikim praktik. Sugjerohet përdorimi i projekteve reale dhe metodologjive bashkëkohore të menaxhimit.

21. Master Profesional Arsim Special

Sugjerohet rritja e praktikës profesionale dhe përdorimi i metodave gjithëpërfshirëse. Feedback-u i studentëve duhet reflektuar në kurrikulë.

22. Master Profesional Arsim Fillor

Rekomandohet integrimi i inovacionit pedagogjik dhe teknologjisë arsimore, në përputhje me gjetjet e monitorimeve.

23. Master Shkencor Financë Bankë

Sugjerohet përdorimi i të dhënave reale bankare dhe thellimi i analizave empirike. Kjo rrit cilësinë kërkimore dhe praktike.

24. Master Shkencor Administrim Biznesi

Raporti tregon nevojën për më shumë projekte inovative. Sugjerohet fokus në sipërmarrje dhe strategji biznesi.

25. Master i Shkencave në Informatikë

Sugjerohet rritja e projekteve kërkimore aplikative dhe përmirësimi i dokumentacionit teknik të tyre

26. Master i Shkencave në të Drejtë Civile dhe Tregtare

Rekomandohet analiza e praktikës gjyqësore dhe standardizimi i vlerësimit akademik.

27. Master i Shkencave në të Drejtë Publike

Sugjerohet përfshirja e rasteve nga administrata publike dhe jurisprudenca aktuale.

28. Master i Shkencave Marrëdhënie Ndërkombëtare

Raporti sugjeron rritjen e analizës strategjike dhe studimeve krahasuese ndërkombëtare.

29. Master i Shkencave Studime Politike dhe Strategjitë Ekonomike të Zhvillimit

Sugjerohet integrimi i analizës ekonomike me politikat zhvillimore, duke rritur komponentin kërkimor.

30. Master i Shkencave Psikologji

Bazuar në focus grupet, rekomandohet rritja e praktikës së mbikëqyrur dhe metodave bashkëkohore të ndërhyrjes.

UMSH, 29.07.2025

Prof. Asoc. Dr. Holta Heba

**Drejtuese e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm,
të Cilësisë, UMSH**